04/09/2026
02/1983

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo infrastrukture i saobraćaja

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Shtimes
Opština Stimlje
Municipality of Shtime

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURORE

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përfaqësuar nga Ministri **Dimal Basha**,
(në tekstin e mëtejmë: "Ministria")

dhe

KOMUNA E SHTIMES

e përfaqësuar nga Kryetari **Qemajl Aliu**,
(në tekstin e mëtejmë: "Komuna")

së bashku të referuara si "Palët".

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i mënyrës së financimit dhe bashkëfinancimit, detyrimeve të Palëve, procedurave të realizimit, mbikëqyrjes teknike dhe financiare, kontrollit, raportimit dhe auditimit si dhe përgjegjësive lidhur me realizimin e projektit infrastrukturor në Komunën e Shtimeit të paraparë në këtë Memorandum.
2. Projekti që do të realizohet në bashkëfinancim nga kjo Marrëveshje është:
   - ***""Asfaltimi i rrugës së Topillës, Carralevë-Zborc dhe Rancë-Greiçevc"- Komuna e Shtimes.***

Neni 2
Natyra e Financimit

1. Financimi sipas kësaj Marrëveshjeje përbën transfer kapital publik për realizimin e projektit infrastrukturor me interes publik.
2. Projekti ***""Asfaltimi i rrugës së Topillës, Carralevë-Zborc dhe Rancë-Greiçevc". – Kodi i projektit 10041.***
3. Shuma e financimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit është **877,818,00€.**
4. Pagesa do të realizohet si në vijim:

   - **610,000.00 € për vitin 2026;**
   - **267,818.00 € për vitin 2027**

5. Dinamika e pagesave realizohet në bazë të progresit të punimeve dhe dokumentacionit financiar të verifikuar.
6. Si pasojë e situatës politike të krijuar gjatë vitit 2025, e cila u karakterizua me mosfunksionimin e Kuvendit dhe pamundësinë e respektimit e afateve ligjore të përcaktuara për procesin e përgatitjes dhe miratimit të qarkoreve buxhetore, Qarkoria e Dytë Buxhetore nuk është përcjellur me kohë dhe si rezultat mjetet buxhetore për projektet nuk kanë mundur të përfshihen në buxhet.

Neni 3
Detyrimet e Ministrisë

1. Ministria obligohet:

   1.1. të sigurojë mjetet financiare sipas ndarjeve buxhetore;
   1.2. të transferojë mjetet sipas progresit të realizimit;
   1.3. të monitorojë realizimin teknik dhe financiar të projektit;
   1.4. të emërojë zyrtar përgjegjës për monitorim dhe menaxhimin e zbatimit të projektit;

1.5. të realizojë kontrolle administrative dhe financiare;
1.6. të kërkojë dokumentacion shtesë kur vlerësohet e nevojshme.

2. Ministria ka të drejtë të pezullojë financimin dhe të kërkojë kthimin e mjeteve në rast të:

2.1. keqpërdorimit të mjeteve;
2.2. shkeljeve të procedurave të prokurimit;
2.3. raportimit të pasaktë ose
2.4. devijimit nga projektet e aprovuara.

Neni 4
Detyrimet e Komunës

1. Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgon në MIT.

2. Komuna obligohet t'i krijojë kushtet e nevojshme për realizimin e projektit për operatorët ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesë të fillojë në implementimin e projekteve me kohë si dhe të sigurojë specifikacionet teknike.

3. Komuna obligohet që projektin ta zhvilloj në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.

4. Komuna e kryen procesin e tenderimit dhe cakton komisionin për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderit.

5. Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projekteve, si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik, në të cilin komision duhet të jetë një anëtar nga MIT, i cili përcakohet nga ZKA e ministrisë.

6. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe cilësinë e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

7. Komuna obligohet që ta njofton MIT-in për çdo propozim apo ndryshim eventual të sasisë dhe cilësisë gjatë implementimit të projekteve dhe për këtë të kërkojë pëlqimin nga MIT.

7.1. Komuna obligohet që në vendpunishte të vendosë tabelën informuese (Pano) me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

8. Komuna obligohet që për t`i realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga MIT-i të kompletoj këto dokumente:

8.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara);

8.2. Kopjen e Kontratës së nënshkruar me operatorin ekonomik, së bashku me ofertën financiare, të vërtetuara në bazë të origjinalit nga menaxheri i prokurimit të Komunës;

8.3. Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës dhe komisionin e pranimit nga ana e Komunës;

8.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara);

8.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MIT-i dhe

8.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave dhe Transfereve).

9. Komuna duhet t`i ndërmarr të gjitha masat që projekti të përfundojë në përputhje me ndarjet buxhetore sipas viteve për këtë projekt. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.

10. Komuna është e obliguar ta njoftojë MIT-in për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dy javor deri në përfundim të projektit.

11. Komuna obligohet ti ndërmarrë dhe ta kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projekteve, përfshirë procedurat dhe kompensimin.

Neni 5
Tejkalimi i vlerës së projektit

1. Në rast se gjatë realizimit të projektit tejkalohet vlera e dakorduar sipas kësaj Marrëveshjeje, çdo kosto shtesë mbulohet nga Komuna e Shtimes.

2. Ministria nuk mban obligime financiare përtej shumës së aprovuar me këtë Marrëveshje.

Neni 6
Standardet teknike dhe ndryshimet e projekteve

1. Projekti realizohet në përputhje me:

   1.1. Standardet më të larta teknike;
   1.2. normat e ndërtimit;
   1.3. specifikimet teknike të aprovuara.

2. Çdo ndryshim i projektit, paramasës, vlerës apo afatit duhet të aprovohet paraprakisht me shkrim nga Ministria.

Neni 7
Mbikëqyrja, Kontrolli dhe Auditimi

1. Palët themelojnë Komision të Përbashkët Mbikëqyrës.
2. Komisioni:

   2.1. monitoron realizimin;
   2.2. verifikon progresin;
   2.3. shqyrton raportet;
   2.4. rekomandon masa korrigjuese.

3. Ministria, Auditorët e Brendshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit kanë të drejtë të qasjes së plotë në dokumentacionin dhe realizimin e projekteve.

Neni 8
Raportimi dhe transparenca

1. Komuna dorëzon:

   1.1. raporte progresive;
   1.2. raport final teknik;
   1.3. raport final financiar.

2. Palët angazhohen për transparencë dhe publikim të informatave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9
Pronësia e Projektit

1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga operatori ekonomik, ky investim (projekt) do të kalojë në pronësi të Komunës.

2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Transfereve (SIMFK).

Neni 10
Integriteti dhe Anti-Korrupsioni

1. Palët obligohen të respektojnë legjislacionin anti-korrupsion dhe rregullat mbi konfliktin e interesit.
2. Çdo dyshim për keqpërdorim apo korrupsion raportohet tek organet kompetente.

Neni 11
Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MIT-it dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. Përtej përcaktimeve të parapara në nenin 3.2 të Memorandumit, MIT-i mban të drejtën e ndërprerjes së financimit të këtij projekti.

Neni 12
Numri i kopjeve

Memorandumi i Mirëkuptimit nënshkruhet në katër (4) kopje, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 13
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Palët.

2. Marrëveshja mbetet në fuqi deri në përmbushjen e plotë të obligimeve të Palëve.

3. Me këtë Memorandum shfuqizohet neni 2, projekti nr. 2 në Memorandumi Nr. 2989 i datës 28.03.2025.

Dimal Basha
Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit

Qemajl Aliu
Kryetar i Komunës së Shtimes

Data: 03.09.2026